

UDHËZIM
Nr. 33, datë 11.3.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 927, DATË 1.11.2021, “PËR
MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATAVE TË
PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATË NË FORMË ELEKTRONIKE, NË
SISTEMIN ELEKTRONIK PËR DEKLARIMIN E PASURIVE DHE
KONFLIKTIT TË INTERESIT (EACIDS)”**

Në mbështetje të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 22.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit EACIDS’”, si dhe shkresave nr. 1021/1 prot., datë 9.3.2021 dhe nr. 1021/2 prot., datë 9.3.2021, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

UDHËZON:

Pika 8, germa “a”, ndryshon si më poshtë vijon:

“8. Subjektet deklaruese duhet të plotësojnë deklaratat e interesave privatë përkatëse, sipas mënyrës dhe afateve të mëposhtme:

a) Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave, për vitin 2021, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë periodike vjetore, në formë elektronike për subjektet në funksion, për pasuritë e akumuluar ndërvite dhe detyrimet financiare, me gjendje më 31.12.2021, si dhe burimin e krijimit të tyre. Deklarata e interesave privatë periodike vjetore, në formë elektronike, për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës 31 tetor 2022, si vijon:

- në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, dhe;

- në formë shkresore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Evgjeni Bashari